



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA / KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

---

NJËSIA PËR INSPEKTIM GJYQËSOR/ZYRA PËR VLERËSIM DHE VERIFIKIM

## R A P O R T

Rekrutimi i Gjyqtarëve/ Nëntor 2023



**Këshilli Gjyqësor i Kosovës**, në mbështetje të nenit 108 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës<sup>1</sup>, Ligjit nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës<sup>2</sup> dhe Rregullores nr.03/2021 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Gjyqtarëve<sup>3</sup>. Më datë: 18 maj 2023 me vendim, Nr. 189/2023, ka nxjerr Vendimin për të shpallur konkursin për përmbushjen e dyzet e shtatë (47) pozitave të lira për gjyqtarë, niveli i Gjykatave Themelore, prej tyre pesë (5) pozita të gjyqtarëve nga komuniteti Serb në Republikën e Kosovës.

Më datën 02 qershor 2023, është publikuar konkursi i cili ka qenë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë.

Për këto pozita të shpallura, aplikacionet e tyre i kanë dorëzuar gjithsej katërqind e dyzet e nëntë (449) kandidatë. Nga ky numër, pas shqyrtimit të aplikacioneve nga ana e Komisionit për Rekrutim janë refuzuar njëzet e dy (22) aplikacioneve të kandidatëve, me arsyetimin se të njëjtit nuk i kanë plotësuar njërën apo më shumë kriteret të përcaktuara me ligj dhe konkurs.

Nga numri i sipër cekur, trembëdhjetë (13) kandidatë kanë paraqitur ankesë në Komisionin për Rishqyrtim dhe nga ky numër, Komisioni ka aprovuar dy (2) ankesa të kandidatëve dhe bazuar në këtë vendim, Komisioni për Rekrutim ka publikuar listën përfundimtare, me emrat e katërqind e njëzet e nëntë (429) kandidatëve të cilët i kanë plotësuar kushtet formale që të vazhdojnë tutje me procesin.

Në testin kualifikues të mbajtur në Akademinë Policore në Vushtrri nga numri i përgjithshëm prej katërqind e njëzet e nëntë (429) kandidatëve me të drejtë pjesëmarrje, në test u paraqitën treqind e shtatëdhjetë e një (371) kandidatë. Nga numri i pjesëmarrësve në testin kualifikues dhe pas kontrollimit të testit në vazhdimësi (pa shkëputje) nga ana e Komisionit për Rekrutim, ka rezultuar se vetëm njëqind e tetëdhjetë e gjashtë (186) kandidatë kanë kaluar me sukses testin kualifikues.

Nga numri i atyre të cilët nuk e kanë kaluar testin kualifikues, njëzet e gjashtë (26) kandidatë kanë shfrytëzuar të drejtën e ankesës në Komisionin për Rishqyrtim. Komisioni për Rishqyrtim pas shqyrtimit të ankesave me vendim ka refuzuar të gjitha ankesat e kandidatëve dhe bazuar në këtë

---

<sup>1</sup>Kushtetuta e Rep. Së Kosovës, neni 108, par. 3 : Këshilli Gjyqësor i Kosovës është përgjegjës për rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërim dhe riemërim për pozita Gjyqësore”.

<sup>2</sup> Ligji për KGJK-në, neni 7 par 1 pika 1.6: Këshilli vendos për shpalljen e konkurseve për kandidatët për pozita në gjyqësor. Pika 1.7 Këshilli vendos për organizimin e provimit për kandidatët për gjyqtarë sipas Rregullores së miratuar në Këshill.

<sup>3</sup> Rregullorja e KGJK-së nr.03/2021 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Gjyqtarëve.

vendim, Komisioni për Rekrutim ka publikuar listën përfundimtare me emrat e njëqind e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë (186) kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet për të vazhduar tutje.

Në testin me shkrim kanë marrë pjesë njëqind e tetëdhjetë e gjashtë (186) kandidatë, nga ky numër tridhjetë e nëntë (39) kandidatë e kanë kaluar testin me shkrim. Komisioni për Rishqyrtim ka pranuar për shqyrtim gjithsej dyzet e një (41) ankesa të kandidatëve të pakënaqur me rezultatin e tyre. Komisioni për Rishqyrtim ka refuzuar të gjitha ankesat si të pabazuara.

Në procesin e intervistës janë ftuar dyzet e tre (43) kandidatë, nga të cilët tridhjetë e nëntë (39) kandidatët e mbetur në proces dhe katër (4) kandidatë të cilët e kanë fituar të drejtën bazuar me ligj dhe rregullore sepse kanë të përfunduar Programim Fillestar të Arsimimit Ligjor - PFAL.<sup>4</sup>

Një kandidat nuk i është përgjigjur ftesës për intervistë.

#### Fazat e procesit (tri faza):

- I. Testi Kualifikues, është mbajtur me datë 15 korrik 2023 në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike dhe Zhvillim në Vushtrri. Rezultatet e testit kualifikues, pas kontrollimit nga ana e Komisionit për Rekrutim pa shprehje janë shpallur me datë 15 korrik 2023 në ora 22:20.
- II. Testi me shkrim, është mbajtur me datë 23 shtator 2023, nga lëmia penale dhe me 24 shtator 2023, nga lëmia civile në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike dhe Zhvillim në Vushtrri. Rezultatet e testit me shkrim, pas kontrollimit nga ana e Komisionit për Rekrutim janë shpallur më datë 29 shtator 2023.
- III. Intervistat dhe si pjesë e saj eseja, kanë filluar të mbahen me datë 16 tetor 2023 në KGJK Prishtinë, intervistës dhe eses i janë nënshtruar gjithsej dyzet e dy (42) kandidatë, një kandidat nuk është paraqitur në intervistë.

Pas publikimit të listës së kandidatëve të intervistuar, dhe rezultateve, kandidatët e pakënaqur me rezultatin kanë pasur të drejtë që në afatin prej tre (3) ditëve të ushtrojnë ankesë te Komisioni për Rishqyrtim. Katër (4) kandidatë të pakënaqur me rezultatin kanë ushtruar ankesë.

---

<sup>4</sup> Rregullore Nr. 03/2021 Për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Gjyqtareve Neni 37 par.1 & 2



Komisioni për Rishqyrtim me datë 10.11.2023, ka shqyrtuar ankesat e kandidatëve ku të gjitha janë refuzuar si të pa bazuara

- Komisioni për Rekrutim në përbërje prej:

1. Qerim Ademaj, Zv. kryesues i KGJK-së/kryetar i komisionit;
2. Vilard Bytyqi, anëtar i KGJK-së/anëtar i komisionit;
3. Drita Rexhaj, anëtare i KGJK-së/anëtare e komisionit;
4. Mustaf Tahiri, kryetar i Gjykatës Themelore Ferizaj, anëtar i komisionit;
5. Faton Bajrami, gjyqtar në Gjykatën Komerciale anëtar i komisionit;
6. Fahret Veliji, anëtar e KGJK-së/anëtar rezervë e komisionit.
7. Snežana Mihajlović, gjyqtare në Gjykatën Themelore Gjilan/anëtare e komisionit

Komisioni për Rekrutim<sup>5</sup> është përgjegjës për sigurimin e mbarëvajtjes së procedurës së rekrutimit, përzgjedhjes preliminare, vlerësimit, përpilimit dhe dërgimit të listës përfundimtare të kandidatëve në Këshill.

- Komisioni për Rishqyrtim në përbërje prej:

1. Ragip Namani, gjyqtar në Gjykatën Supreme/anëtar i komisionit;
2. Arjeta Sadiku, anëtare e KGJK-së/anëtare i komisionit;
3. Bujar Muzaqi, gjyqtar në Gjykatën e Apelit/anëtar i komisionit.
4. Sahit Sylejmani, gjyqtar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme/ anëtar rezervë i komisionit.
5. Fidan Hoxha, anëtar i KGJK-së, anëtar rezervë i komisionit.

Komisioni për Rishqyrtim<sup>6</sup> është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve ndaj vendimeve të Komisionit për Rekrutim.

- Njësia për Inspektim Gjyqësor/Zyra për Vlerësim dhe Verifikim:

---

<sup>5</sup> Rregullorja e KGJK-së nr. 03/2021 neni 5 Komisioni për Rekrutim.

<sup>6</sup> Rregullorja e KGJK-së nr. 03/2021 neni 6 Komisioni për Rishqyrtim.

NjIGj/ZVV në mbështetje të Komisioneve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është përgjegjëse për zbatimin e drejtë të procesit të Vlerësimit dhe Verifikimit të kandidatëve<sup>7</sup>, duke përfshirë dhe siguruar bashkë me Komisionet përgjegjëse të Këshillit Gjyqësor, vlerësimin dhe verifikimin e informatave të siguruar nga kandidatët dhe burimet tjera, aftësitë, të arriturat profesionale, historikun e së kaluarës eventuale penale dhe masat disiplinore, aspektin financiar përmes kontrollimit të raporteve bankare, asetëve dhe pasurive të cilat i raportojnë dhe i dorëzojnë në formë fizike dhe elektronike kandidatët e të cilat po ashtu verifikohen nga ana e institucioneve relevante ( Gjykata, Prokurori, Policia e Kosovës, ATK , Agjencia Kundër Korrupsion, Kadastër dhe ARBK).

Detyrë parësore e ZVV-së, fillimisht është, të sigurojë të dhënat për kandidatët, të cilët arrijnë të përmbushin kriteret e kërkuara (parapara) ligjore për pozitat përkatëse, në mënyrë që të lehtësojë punën e Komisioneve me qëllim që emërimet të bëhen mbi bazën e meritokracisë dhe trajtimit të barabartë dhe për kandidatët në garë më tutje, ka obligim që të shqyrtoj, analizoj, verifikoj të dhënat e raportuara, konfirmuara dhe në fund për Komisionin për Rekrutim të përpiloj Raport me shkrim lidhur me të gjeturat.

#### Aktivitetet e ZVV-së në ndihmë Komisioneve:

1. Përgatitja e planit të veprimit në koordinim dhe bashkëpunim me Komisionin për Rekrutim lidhur me mbarëvajtjen e procesit i cili ndërlidhet me të tri fazat;
2. Kërkesat drejtuar institucioneve lidhur me informacionet specifike për kandidatët;
3. Ndihma profesionale dhe teknike Komisionit për Rekrutim dhe Komisionit për Rishqyrtim;
4. Përpilimin e vendimeve dhe njoftimeve lidhur me procesin në koordinim me Komisionet;
5. Mbajtja e kontakteve dhe korrespondencave sipas nevojë me institucione, kandidatë etj., në emër dhe për Këshillin dhe Komisionet e Këshillit Gjyqësor;
6. Përpilimin e Raportit përfundimtar të procesit në tërësi, në koordinim dhe bashkëpunim të plotë me Komisionin për Rekrutim të KGJK-së.

---

<sup>7</sup> Rregullorja e KGJK-së nr. 03/2021 neni 23 Procesi i verifikimit të integritetit personal dhe profesional të kandidatit.

Raporti i verifikimit dhe vlerësimit të kandidatit dhe dosja e kandidatit, përgatiten në kronologji nga ana e zyrtarëve të caktuar të ZVV-së, dhe të njëjtat i dorëzohen Komisionit për Rekrutim para fillimit të intervistës së kandidatit, në mënyrë që Komisioni të posedojë të gjitha informatat e nevojshme për vlerësim të drejtë dhe objektiv, duke poseduar të gjitha informatat e nevojshme lidhur me kandidatin.

**Paraqitja tabelare dhe shpjegimi lidhur me procesin e rekrutimit:**

➤ Tabela: 1 Testi kualifikues.

<b>Testi Kualifikues, data e mbajtjes 15 korrik 2023</b>			
<b>Faza e I-rë</b>	<b>Kandidatët e ftuar</b>	<b>Kandidatët pjesëmarrës</b>	<b>Gjithsej kanë kaluar</b>
<b>Testi Kualifikues</b>	429	371 179 F dhe 192 M	186 96 F dhe 90 M

**Shpjegim:** Përpilimi i testit kualifikues ka filluar në orën 07:00 të datës 15 korrik 2023, në Akademinë Policore në Vushtrri, nga ana e Komisionit, stafit mbështetës dhe me prezencë të monitoruesve të procesit. Testi kualifikues ka filluar në ora 12:00 – 14:00. Komisioni për Rekrutim ka arritur që ti kontrollojë testet e të gjithë kandidatëve pjesëmarrës në testin kualifikues, në afat kohor përafërsisht prej nëntë (9) orësh pas përfundimit të testit kualifikues, në vazhdimësi të njëjtën ditë janë publikuar rezultatet. Komisioni për Rekrutim ka shpallur rezultatet e testit kualifikues pa u larguar nga objekti i mbajtjes së testit. Pastaj ka pasuar procedura e ankimimit të kandidatëve të pakënaqur me rezultatin e tyre pranë Komisionit për Rishqyrtim. Pas shqyrtimit të ankesave të kandidatëve, rezultati ka përfunduar me numrin e sipër cekur prej 163 kandidatëve.

➤ Tabela: 2 Testi me shkrim.

<b>Testi me shkrim dhe data e mbajtjes 23 dhe 24 shtator 2023</b>			
<b>Faza e II-të</b>	<b>Kandidatët pjesëmarrës</b>	<b>Penale/ Civile</b>	<b>Gjithsej kanë kaluar</b>
<b>Testi me shkrim</b>	186	186/185	39 17 F dhe 22 M

**Shpjegim:** Përpilimi i detyrës penale ka filluar në orën 07:00 të datës 23.09.2023, në Akademinë Policore në Vushtrri. Testimi nga detyra penale ka filluar ne ora 12.00 të së njëjtës ditë. Ndërsa



përpilimi i detyrës civile ka filluar në orën 07.00 të datës 24.09.2023, në sallën e Akademisë Policore. Testimi ka filluar të mbahet në ora 12.00 të së njëjtës ditë. Komisioni për Rekrutim ka arritur që ti kontrolloj testet me shkrim nga lëmia penale dhe civile e të gjithë kandidatëve pjesëmarrës, në një afat kohor prej pesë (5) ditësh pas përfundimit të testimit dhe është publikuar lista me gjithsej tridhjetë e nëntë (39) kandidatë të cilët e kanë kaluar testin me shkrim. Komisioni për Rishqyrtim ka pranuar gjithsej dyzet e një (41) ankesa të paraqitura për rezultatin e arritur (publikuar). Pas përfundimit të procedurave të shqyrtimit të ankesave të kandidatëve, është publikuar rezultati i sipër shënuar prej gjithsej dyzet e tre (43) kandidatëve të cilët kanë fituar të drejtën për garën e mëtejme duke përfshirë tridhjetë e nëntë (39) kandidatë të cilët kanë kaluar testin me shkrim dhe katër (4) kandidatë të cilët kanë pasur të përfunduar PFAL-in.

➤ Tabela: 3 Intervista dhe eseja.

<b>Intervista dhe eseja , fillimi i intervistave 16 tetor 2023</b>			
<b>Faza e III-të</b>	<b>Kandidatët e ftuar në intervistë dhe ese</b>	<b>Kandidatët pjesëmarrës</b>	<b>Gjithsejtë kanë kaluar</b>
<b>Intervistat &amp; ese</b>	39+4=43	42	15 6 F dhe 9 M

➤ Tabela: 4 Tri fazat rekrutuese.

<b>Testi Kualifikues, testi me shkrim dhe intervista. Gjithsej pjesëmarrës për tri fazat:</b>			
<b>Lloji i testit</b>	<b>Kandidatë pjesëmarrës</b>	<b>Civile / Penale</b>	<b>Gjithsej kanë kaluar</b>
<b>Testi Kualifikues</b>	371		186 (%)
<b>Testi me shkrim civile/penale</b>	186	185/186	39 (20.97%)
<b>Intervistat &amp; ese</b>	39 + 4 PFAL		15 (34.88%) 6 (40)% F 9 (60)% M

➤ Tabela: 6 Përkatësia etnike e kandidatëve pjesëmarrës.

<b>Përkatësia etnike e kandidatëve të cilët kanë konkurruar për pozitën gjyqtarë:</b>				
	<b>Publikimi i listës</b>	<b>Faza e I-rë</b>	<b>Faza e II-të</b>	<b>Faza e III-të</b>
<b>Shqiptar</b>	426 (99.30%)	186 (100%)	39 (100%)	15 (100%)
<b>Tjera</b>	3 (0.70%)	-	-	-

- Tabela: 7 Afatet kohore prej fillimit të testit kualifikues, me shkrim dhe intervistave - deri në rezultatin përfundimtar të rezultateve të tyre (kontrollimit dhe shpalljes së rezultateve).

Fazat (I, II, III)	Fillimi i secilës fazë	Mbarimi i secilës fazë	Kohëzgjatja e përpilimit të testit, esesë dhe intervistës deri të mbajtja	Kohëzgjatja e kontrollimit (intervistimit) nga Komisioni për Rekrutim
Testi kualifikues	15/07/2023	15/07/2023	6 orë	11 orë
Testi me shkrim	23/07/2023 24/07/2023	23/07/2023 24/07/2023	4 orë 4 orë	5 ditë
Intervistat/eseja	16/10/2023	02/10/2023	30 min.	1 orë 8 orë

**Shpjegim:** Pas shpalljes së rezultateve lidhur me tri fazat nga ana e Komisionit për Rekrutim, duhet pasur në konsideratë se çdo herë ka rrjedhur procesi i ankimimit nga ana e kandidatëve të pa kënaqur me rezultatin e arritur në testim e i cili çdo herë ka pasur impakt në zgjatjen e procesit dhe kalimit në fazën tjetër. Komisioni për Rekrutim, në çdo fazë ka mbetur në pritje të rezultateve të Komisionit për Rishqyrtim pas përfundimit të procedurës së ankimimit nga ana e kandidatëve të pakënaqur me rezultatin e publikuar (arritur).

Prishtinë

Datë: 29.11.2023

Kryetar i Komisionit për Rekrutim

Qerim Ademaj

